

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është Charles Smith, amerikani që dënoi me 81 vjet burgim ish krerët e UÇK-së
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/kush-eshte-charles-smith-amerikani-qe-denoi-me-81-vjet-burgim-ish-kreret--i586482
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:48:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e1a109e3e53e3638794bc9baa6bb54bdc9eea07d30e2a946e56e923d484255fb
TEKSTI	6bbebfd71c806265e3f84e11013bde0b822c928653a2d161cb5ac73ceac21e8a
PAMJA	bf009b47878b6b9becceeb33cd5074ba03dc90e66838531c7ec8e3157e89e184

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	17e67d11a96a9f8018f3546716d6a729f76ba17bfc46c88ef0924c5710ce31ec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/17e67d11a96a9f8018f3546716d6a729f76ba17bfc46c88ef0924c5710ce31ec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English




Ne u beme siç enderruam Paradoksi i drejtësisë nderkombetare: Si mund të përfundojnë në denime të ngjashme dy ane të kundërta të historisë? Zhblikohen procedurat fundit

Kush është Charles Smith, amerikanë që dënoi me 81 vjet burgim ish krerët e UÇK-së



16 Shtator 2026, 15:10Rajoni TEMA



Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe lexoi aktgjykimin e shqiptuar nga Dhoma e Specializuar në Hagë.

Smith, shtetas i Amerikës, është emëruar gjyqtar në Dhoma e Specializuar më 7 shkurt 2017. Përveç drejtimit të panelit në rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ai është edhe nënkryetar i kësaj gjykate që nga 29 prilli 2020.

Karriera e tij në Kosovë kishte nisur vite para krijimit të Dhomave të Specializuara. Nga viti 2010 deri më 2013, ai shërbeu si gjyqtar i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit – EULEX.

Në kuadër të këtij mandati, Smith ishte anëtar i Gjykatës Supreme të Kosovës nga viti 2011 deri më 2013. Gjatë kësaj periudhe u zgjodh fillimisht nënkryetar, e më pas kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, thuhet në biografinë e tij, të shfaqur në uebfaqen e Dhomave të Specializuara..

Para angazhimit në Kosovë, ai kishte një karrierë të gjatë në sistemin amerikan të drejtësisë. Në vitin 1990 u emërua gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Distriktin e Katërt Gjyqësor të shtetit Iowa,

Nga viti 1996 deri më 2010, Smith shërbeu si kryegjyqtar në këtë distrikt dhe ishte njëkohësisht anëtar i Këshillit Gjyqësor të Iowas.

Përpara emërimit si gjyqtar, nga viti 1970 deri më 1989, ai ushtroi profesionin e avokatit privat. Veprimtaria e tij përfshinte çështje civile dhe penale, si dhe raste që lidheshin me biznesin, tatimet dhe trashëgiminë.

Smith përfundoi studimet për drejtësi në Universitetin Creighton në Shtetet e Bashkuara, ku mori gradën "Juris Doctor" në vitin 1970. Po atë vit u pranua në Odën e Avokatëve të Nebraskës, ndërsa më 1971 në atë të Iowas, që është njëra nga shtetet më miqësore amerikane me Kosovën.

Prej vitit 2014 ai ka punuar edhe si ndërmjetësues dhe arbitër.

Në Dhomat e Specializuara, Smith ka kryesuar gjithashtu trupin gjykues në çështjen ndaj ish-drejtuesve të OVL-UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Krahas funksionit të nënkryetarit të gjykatës, ai ushtron edhe detyrën e gjyqtarit të lartë për ankesat e personelit./KosovaPress

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

14:10 Rajoni / 2 komente

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, BE apel për përmbajtje: Drejtësia të vijojë pa ndërhyrje](#)

14:00 Rajoni / 7 komente

Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht

13:50 Rajoni / 5 komente

Ministri Gogu pas vendimit të Hagës: "Lufta e UÇK-së ishte luftë e drejtë, asnjë vendim gjykate nuk e ndryshon këtë"

13:40 Rajoni / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.